

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	AKEP ndalon klauzolat e indeksimit, rritja e çmimit të celularëve duhet të parashikohet në vlerë
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/-ndalon-klauzolat-e-indeksimit-rritja-e-cmimit-te-celular-eve-duhe-i103976
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 06:00:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 05:54:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f972a41adbedf6aa4190856373bc80e9bc178d793c577d6f543e3b82c7c28409
TEKSTI	99cc120885e1ccc4bdb3ade684cfe2589941f36a2b383a5554a8d3e6fb233dc5
PAMJA	b5e71db0169b6dcd29aa79c632aff0340142a2a45c2d673120ed1c0cceec4a21

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ab73f2169f612a390f33f6316346f4b3ea4012b10da98f9b559e0dca64f4cbca
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ffd91b584b7f6ad6fe6fe6255283fcbda7dbe303bf00ea6d85b435b755931683
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ab73f2169f612a390f33f6316346f4b3ea4012b10da98f9b559e0dca64f4cbca>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

**e plagos me
çekiç! Në
kërkim autori**

**Roskuvetit,
ku një
shtetas
dëshohet se**

**shqiptarët,
në Gjermani**

**serisi me
ritme të
larta në 10
vitet e**

temperaturat

**pritet të
shkojnë deri
në 31&de...**

**Mesatarisht
34 mijë lekë**

**eshtë
falas, por
hyrja në
të nuk**


**secien
shenjë**

**niku
thotë
të
në**

AKTUALITET

AKEP ndalon klauzolat e indeksimit, rritja e çmimit të celularëve duhet të parashikohet në vlerë

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 07:54



Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) do të ndalojë aplikimin e klauzolave të ndryshimit të tarifave, të shprehura në përqindje, në kontratat e operatorëve të komunikimeve elektronike.

Projekt-rregullorja për "Mbrotjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike" parashikon se informacioni kontraktor në lidhje me çmimin, duhet të përfshijë në mënyrë të dukshme dhe të qartë dhe tarifën e pajtimit mujor, duke përfshirë çdo ndryshim të parashikuar të tarifës së pajtimit mujor që konsumatori do të paguajë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës me afat të caktuar, të shprehura në Lekë me TVSH. Në këtë pikë, nuk do të lejohen ndryshimet e deklaruara në përqindje.

Një risi tjetër e projekt-rregullores është edhe detyrimi i sipërmarrësit që përpara lidhjes së kontratës t'i vendosin në dispozicion pajtimtarit të kategorisë "Konsumator" përmbledhjen e kontratës, pa pagesë.

Informacioni për çmimin në përmbledhjen e kontratës duhet të përfshijë edhe informacionin e referuar për tarifën e pajtimit mujor, përfshirë çdo "ndryshim të parashikuar të tarifës së pajtimit mujor" që konsumatori do të paguajë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës me afat të caktuar ose periudhës së angazhimit kontraktual, të shprehura në Lekë me TVSH.

Përmbledhja e kontratës synon rritjen e transparencës, me qëllim që konsumatori të jetë i qartë për termat kryesorë të kontratës që do të nënshkruajë, duke pasur parasysh që kontratat e plota mund të jenë relativisht të gjata, të detajuara dhe konsumatori mund të mos jetë plotësisht i vëmendshëm në të gjithë elementët e përfshirë në to.

Ndalimi i parashikimeve për rritjen e tarifave në përqindje nuk do t'u lejojë më operatorëve të komunikimeve elektronike të përfshijnë në kontratat e tyre të ashtuquajturën klauzolë indeksimi me inflacionin.

Dy operatorët më të mëdhenj të komunikimeve elektronike në vend, Vodafone Albania dhe One Albania, parashikojnë në termat dhe kushtet e përgjithshme për shërbimet e rrjetit celular dhe rrjetit fiks të kategorive "Konsumator" dhe "Biznes" një klauzolë të veçantë, ku rezervonin të drejtën për të indeksuar çmimet e shërbimeve të tyre me normën e inflacionit të vitit të mëparshëm.

Megjithatë, deri tani, vetëm njëri nga operatorët ka aplikuar rritje e çmimesh sipas kësaj klauzole. Për herë të parë, kjo u bë më datë 1 qershor 2024 dhe vetëm për pajtimtarët e kategorisë "Biznes", ndërsa duke filluar nga 1 maji 2026 indeksimi u aplikua në të gjithë bazën e klientëve të shërbimeve celulare.

AKEP ndjek praktikën e rregullatorit britanik

Përcaktimi i klauzolave që u lejojnë operatorëve të indeksojnë automatikisht tarifat e produkteve dhe shërbimeve me inflacionin ngelet çështje objekt diskutimesh edhe në Bashkimin Europian, por, deri tani, kuadri ligjor nuk e ndalon aplikimin e klauzolave të tilla.

Megjithatë, Trupa e Rregullatorëve Europianë të Komunikimeve Elektronike (BEREC), në vitin 2024 e ka konsideruar përfshirjen dhe aplikimin nga operatorët në vendet të klauzolave kontraktore për rritje të çmimit gjatë kohëzgjatjes së kontratës (In-contract price increase clauses) sipas ICK and ICK plus një marrësi si "zhvillim me ndikim shoqëror në të drejtat dhe në fitimet e

përdoruesve fundorë, pasi në disa raste ato kanë rezultuar në rritje të ndjeshme të tarifave dhe përdoruesit nuk kanë të drejtën e ndërprerjes pa penalitet të kontratës”.

Opinionin dhe propozimin e BEREC për Komisionin Europian për këtë çështje është se “këto klauzola paraqesin sfida për sa i përket konkurrencës, përballueshmërisë, lëvizshmërisë (ndërrimit të ofruesit së shërbimit) së përdoruesit fundor, transparencës dhe krahasueshmërisë së çmimeve. Përdorimi i tyre krijon rrezik që objektivat e kuadrit ligjor për mbrojtjen e konsumatorëve të mos përmbushen”.

Komisioni Europian deri më sot nuk ka shprehur një qëndrim përfundimtar lidhur me rekomandimin e BEREC.

Megjithatë, një rregullim i ndryshëm ligjor ekziston në Britaninë e Madhe. Autoriteti britanik i komunikimeve elektronike (OFCOM) në vitin 2024 vendosi ndryshime në kuadrin rregullator, të cilat e ndalojnë aplikimin e rritjes së tarifave të shprehura në përqindje (IÇK). Çdo rritje e parashikuar çmimesh gjatë kohëzgjatjes së kontratës duhet të shprehet në terma monetare.

AKEP ka vendosur të ndjekë të njëjtën linjë me OFCOM, duke kërkuar që rritja e parashikuar e çmimeve gjatë afatit të kontratës së shprehet detyrimisht në vlerë. /Monitor

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 14 Shtator07:46

[Sherr me babain e ish-bashkëjetueses, e plagos me çekiç! Në kërkim autori](#)

Një plagosje ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në fshatin Suk të Roskovecit, ku një shtetas dyshohet se është goditur me &ccedi...

AKTUALITET 14 Shtator07:38

[Emigracioni/ BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët, në Gjermani numri arrin rekordin e 124 mijë](#)

Emigracioni i shqiptarëve drejt Bashkimit Europian ka mbetur sërish me ritme të larta në 10 vitet e fundit, dhe gradualisht po tejkalon va...

AKTUALITET 14 Shtator07:20

[Njihuni me parashikimin e motit për sot, ja sa do të jenë temperaturat](#)

Moti do të jetë i qëndrueshëm gjatë ditës së sotme, ndërsa temperaturat pritet të shkojnë deri në 31&de...

AKTUALITET 13 Shtator23:18

[Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dyshohet se është i përfshirë Alket Rizai](#)

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

AKTUALITET 13 Shtator23:04

[E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë në oborrin e banesës](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos.Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

AKTUALITET 13 Shtator22:16

[“Rama na preu në besë”/ Dita e 45-së e protestës, Divjaka kundër Territoriale: Nuk pranojmë të bashkohemi me Lushnjen](#)

Divjaka vijon protestën kundra projektit të PS për shkrirjen e bashkisë dhe kalimin në varësi të Lushnjes. Identiteti, hist...

AKTUALITET 13 Shtator20:55

[KPP merr fuqi mbi koncesionet: Mund t'i pezullojë menjëherë ose...](#)

Kontratat koncesionare dhe partneritetet publik-privat do të kalojnë nën një kontroll më të fortë administrativ, pasi ...

AKTUALITET 13 Shtator18:18

[Përmbytjet në Elbasan, banorët kërkojnë ndihmë: Na gjeni strehim](#)

Reshjet e dendra të shiut kanë shkaktuar përmbytje dhe probleme të shumta në qytetin e Elbasanit. Brenda vetëm 30 minutash, rr...

AKTUALITET 13 Shtator17:36

[“Dje thonte furnizojmë vendet në konflikt, sot premton se do të prodhojmë armë”/ Këlliçi nxjerr zbuluar ministrin Nufi: Ermal Raketa flet për trafik apo...](#)

Nënkryetari i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi ka “nxjerrë zbuluar” ministrin e Mbrojtjes Ermal Nufi. Në një...

AKTUALITET 13 Shtator16:48

[Përleshje mes 15 personash në Athinë, plagoset 40-vjeçari. Në pranga shqiptari dhe dy të tjerë](#)

Një përleshje e dhunshme ku përfshiheshin afërsisht 15 persona u regjistrua të shtunën në Athinë, Raportohet se pas ngja...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

["Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...](#)

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

["Dil jashtë", u përplas me Edi Ramën për "Terri...](#)

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

BOTA 13 Shtator

[A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një lufte t...](#)


Lufta mes SHBA-së dhe Iranit ka zgjatur shumë më tepër nga sa pritej, por pavarësisht tronditjeve, tregu global i naftës ka tregua...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.